



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:278391
Datë: 08.04.2024
Numri i dokumentit: 05559621

C.nr.2340/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Argzon Muçaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.A. nga fshati K., Komuna N. me numër personal..., i përfaqësuar sipas autorizimit nga A.H., avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Qeveria e Kosovës MPB - PK, me seli në P., e përfaqësuar nga F.B. sipas autorizimit, me objekt kontesti: anulimi i vendimit, në seancën e shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 22.03.2024 në prani të paditësit me të autorizuarin e tij dhe të autorizuarës së të paditurës, ndërsa me datë 08.04.2024 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit A.A. nga fshati K., Komuna N., me të cilën ka kërkuar që të anulohet Vendimi Nr. 06/01628 i datës 10.09.2019 si dhe rezultati i ekzaminimit mjekësor i Klinikës A., të vërtetohet se i plotëson kushtet shëndetësore për vendin e punës zyrtar policor dhe të obligohet e paditura që t'i njoh këtë të drejtë dhe të sistemoj në vendin e punës zyrtar policor.

II. Shpenzimet procedurale secila palë i bartë për vete.

A r s y e t i m

Paditësi A.A. nga fshati K., Komuna N., me numër personal..., i përfaqësuar sipas autorizimit nga A.H., avokat nga Gjilani, Rr..., nr..., me datën 27.11.2019 ka paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të anulohet Vendimi Nr. 06/01628 i datës 10.09.2019 si dhe rezultati i ekzaminimit mjekësor i Klinikës A., të vërtetohet se i plotëson kushtet shëndetësore për vendin e punës zyrtar policor dhe të obligohet e paditura që t'i njoh këtë të drejtë dhe të sistemoj në vendin e punës zyrtar policor.

Fillimisht, paditësi më datë 10.10.2019 padinë e ka paraqitur në Departamentin Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, mirëpo, me vendimin e datës 11.10.2021 kjo gjykatë shpallet jo-kompetente në pikëpamje lëndore dhe me datë 10.11.2021 lëndën e dërgon në Gjykatën Themelore në Gjilan - Dega e N., po ashtu, edhe kjo e fundit shpallet jo kompetente dhe lënda dërgohet në procedurë kontestimore në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Paditësi përmes padisë, ka theksuar se ka marr pjesë në konkursin e publikuar për vende pune zyrtar policor dhe staf civil që nuk janë shërbyes civil, i është nënshtruar të gjitha procedurave, si dhe procedurës në aspektin psiko – fizik. Më tutje ka shtuar se, sipas Komisionit të formuar nga e paditura, nuk i ka plotësuar kriteret shëndetësore, duke u përjashtuar nga procesi i mëtejshëm. Tutje, ka shtuar se duke u bazuar në provat materiale të cilat i posedon paditësi, dhe atë në raportin e laboratorit të analizave mjekësore të datës 17.07.2019, raportin e ordinancës specialistike G. Nr. 1269 të datës 13.09.2019, raportin e laboratorit mjekësor M. i datës 13.09.2019, del se konstatimet që janë dhënë në raport nga e paditura nuk janë të qëndrueshme, dhe me këtë rast i është bërë shkelje e të drejtave themelore. Ndërsa, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përmes të autorizuarit të tij, ka qëndruar prapa padisë së paraqitur në gjykatë, duke konsideruar se e paditura në mënyrë të kundërligjshme ka zhvilluar procesin e rekrutimit të stafit për pozitën e zyrtarit policor dhe atë në kundërshtim të plotë me kushtet dhe kriteret e përshkruara në konkursin e shpallur. Më tutje, ka theksuar se, i ka kryer të gjitha testet e organizuara nga e paditura, duke filluar nga testet me shkrim, të gjitha testet fizike, testin e intervistës me gojë, mirëpo i njëjti kishte dështuar në testin e ekzaminimit mjekësor të mbajtur me datë 26.08.2019 në klinikën private A., e që e njëjta është e kontraktuar nga e paditura për të kryer ekzaminimet e tilla. Ka shtuar se, analizat e gjakut apo testet hematologjike të bëra në klinikën A. me datë 26.08.2019, janë të falsifikuara dhe atë më qëllimin e njëjtë për eliminimin apo përjashtimin e paditësit nga konkursi i shpallur nga e paditura. Paditësi pretendon se këto teste mund të vërtetohen me sigurimin e dy raporteve mjekësore të njëjtës datë, por të njëjtat me vlera të ndryshme. Tutje, ka theksuar se, ka përsëritur teste hematologjike në disa klinika publike dhe private, dhe të gjitha kanë rezultuar pozitiv dhe nuk është vërtetuar asnjë simptomë e sëmundjes e cila është përshkruar në analizat hematologjike në klinikën A.. Paditësi, gjithashtu thekson se e paditura ka vepruar kundërligjshëm në konkursin e publikuar dhe atë në kundërshtim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht me nenin 3, 24 dhe 41 të saj, e njëjta ka shkelur edhe Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut si dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, respektivisht nenin 14 të saj. Nga gjykata ka kërkuar që kërkesëpadia të aprovohet si e bazuar, të anulohet Vendimi i datës 10.09.2019 i cili në mënyrë të kundërligjshme është nxjerr nga e paditura, të obligohet e paditura të kthej në vendin e punës në pozitën e zyrtarit policor, të njëjtin të pajisë me kontratë të punës dhe me të gjitha të drejtat që burojnë nga ligji.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, por të njëjtat nuk i ka specifikuar.

E paditura, përgjigje në padi nuk ka paraqitur, ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se vendimi i Drejtorisë së Përgjithshme të P.K. është i drejtë dhe i bazuar në prova, duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit të refuzoj si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse ka administruar provat: ankesën e datës 05.09.2019 e paraqitur nga paditësi A.A., rezultati i analizave nga laboratorit B.E. i datës

05.09.2019, raporti mjekësor i ordinancës specialistike G. i datës 13.09.2019, raporti i analizave Biokimike i laboratorit M. i datës 13.09.2019, vendimi i Drejtorisë së Përgjithshme të P.K. i datës 16.09.2019, rezultatet e analizave nga laboratorit B.E. të datës 20.08.2019 dhe të datës 26.10.2019 dhe raporti i analizave nga klinika A. i datës 28.02.2020.

Gjykata, pas vlerësimit të pretendimeve të paditësit dhe provave të administruara si me lartë, e duke u bazuar në nenin 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Në mes të palëve ndërgjyqëse, nuk ishte kontestuese se paditësi ka marrë pjesë në procedurën e rekrutimit për punësim në pozitën e zyrtarit policor në P.K., e po ashtu, nuk ishte kontestuese se i njëjti i ka kaluar me sukses fazat e testimit, përfshirë testin fizik, testimin me shkrim dhe pjesën e intervistës.

Nuk ishte kontestuese në mes të ndërgjyqësve se paditësi, edhe pse kishte kaluar me sukses fazat e testimit përgjatë procedurës së rekrutimit të tij si zyrtar policor, i njëjti ishte diskualifikuar në procedurën e ekzaminimit mjekësor, ashtu që, i njëjti i ishte nënshtruar kontrolleve përkatëse me datë 26.08.2019 në institucionin shëndetësor A., i cili institucion ka qenë i autorizuar për të kryer ekzaminimet e tilla.

Po ashtu, nuk ishte kontestuese, se paditësi kishte ushtruar ankesë me datë 05.09.2019 ndaj njoftimit të paditurës, duke e bazuar ankesën në raportin e disa prej analizave laboratorike që paditësi i kishte kryer në institucione të tjera shëndetësore. Ndërsa e paditura me Vendimin e datës 10.09.2019, kishte refuzuar të pabazuar ankesën e paditësit, duke lënë në fuqi rezultatin e ekzaminimit mjekësor të klinikës A., në cilësi të institucionit të autorizuar për kryerjen e ekzaminimeve mjekësore nga P.K.. Këtë vendim, paditësi e kishte pranuar me datë 16.09.2019.

Mirëpo, çështje kontestuese në mes të palëve ndërgjyqësve, del të jetë përshtatshmëria e paditësit për të ushtruar funksionin e zyrtarit policor tek e paditura, duke pas parasysh rezultatet e ekzaminimeve të tij mjekësore. Prandaj, me qëllim të konstatimit të drejtë të kësaj çështjeje, gjykata sipas propozimit të palës paditëse, ka administruar dhe vlerësuar provat e lartcekura, mbi bazën e pretendimeve të paditësit.

Në raport me këto prova, paditësi pretendon mbi bazën e krahasimit të rezultateve mjekësore të kryera në laboratorë të ndryshëm, e po ashtu edhe në klinikën A., të arrihet në përfundim se rezultatet e kryera sipas udhëzimeve të të paditurës, nuk janë të qëndrueshme, dhe se të njëjtat nuk e përcaktojnë në mënyrë të drejtë gjendjen shëndetësore të paditësit.

Fillimisht, në aspektin e së drejtës materiale, gjykata vlerëson se Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë, paraqet ligj të veçantë që rregullon fushë veprimtarinë në Policinë e Kosovës, i cili në nenin 44 përcakton se Policia e Republikës së Kosovës punëson tri kategori të personelit policor, ndërsa, e njëjta dispozitë në raport me marrëdhënien e punës për personelin policor parasheh se e njëjta rregullohet me akt nënligjor. Bazuar në këtë dispozitë, rregullimi i marrëdhënies së punës për personelin policor është bartur në nivel të aktit nënligjor, duke i lejuar një hapësirë diskreionale

të paditurës që përmes aktit nënligjor të përcaktoj kriteret dhe procedurën e zhvillimit të konkursit. Në lidhshmëri me këtë, gjykata vlerëson se këto kompetenca diskrecionale nuk janë të pakufizuara, mirëpo përmes kësaj synohet vendosja e një balancimi ndërmjet respektimit të kërkesave në procedurë administrative, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së të drejtave të individit, nga ana tjetër.

Më tutje, marrëdhënia e punës rregullohet përmes aktit nënligjor dhe atë me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2018 për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili rregullon çështjet e punësimit tek e paditura duke përfshirë edhe konkursin, në kohën kur i referohet paditësi, pjesëmarrës i të cilit ka qenë. Me nenin 15 të këtij Udhëzimi Administrativ rregullohet procedura e testimit të kandidatëve, i cili përcakton se: *“1. Kandidatët të cilët sipas konkursit të shpallur i plotësojnë kriteret e përcaktuara do t’u nënshtrihen procedurave të testimit; dhe 2. Procedura e testimit mbahet sipas radhitjes vijuese: 2.1. Testimi me shkrim; 2.2. Testimi i shkathësive fizike; 2.3. Intervistës me gojë; 2.4. Testimi psikologjik; 2.5. Kontrolli mjekësor dhe 2.6. Verifikimi i së kaluarës.”* Ndërsa, paragrafi 3 i këtij neni përcakton se: *“Kandidati që dështon në njërën nga fazat e testimit, nuk ka të drejtë të ri testohet dhe nuk ka të drejtë të vazhdojë në fazat tjera të testimit.”*

Bazuar në dispozitat e lartcekura, gjykata vlerëson se procedura e testimit të kandidatëve realizohet përmes një procedure administrative dhe kalon në disa faza, në të cilat parashihet detyrimi i kandidatit për plotësimin e një sërë kriterëve formale. Në lidhshmëri me këtë, për t’u zgjedhur në pozitën e zyrtarit policor, së pari duhet të plotësohen kriteret formale për konkurrim, dhe së dyti kalimi me sukses i fazave testuese dhe njëkohësisht, e tërë procedura e konkursit realizohet përmes ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit në këtë rast nga e paditura.

Kurse, më tutje, sa i përket kontrollit mjekësor, me nenin 20, paragraf 3 të këtij Udhëzimi Administrativ, përcaktohet se mbahet në institucionin e autorizuar nga e paditura, që në rastin e konkret ka qenë institucioni shëndetësor A. në P.. Ndërsa, me Procedurat Standarde të Operimit (dokument i aprovuar në mars 2018), e paditura ka përcaktuar se: *“mjeku duhet të kryejë një kontrollim adekuat shëndetësor për të zbuluar dëshmi mbi paaftësinë shëndetësore apo ndonjë sëmundje që do ta kishin penguar kandidatin për të kryer funksionet kryesore në vendin e punës në Polici, për të cilin ai/ajo ka konkurruar.”* Kurse, bazuar në rezultatet e kontrollimit fizik, mjeku i kontrollit mjekësor duhet të rekomandoj se kandidati i përmbush kushtet minimale mjekësore ose të rekomandojë se kandidati nuk i përmbush kushtet minimale mjekësore, dhe varësisht nga vlerësimi të përcaktojë qartazi se kandidati “ka kaluar” apo “ka dështuar” në kontrollin mjekësor. Në rastin e paditësit, bazuar në Vendimin e Drejtorisë së Përgjithshme të P.K. i datës 16.09.2019, vlerësimi dhe diagnoza e dhënë nga mjeku i specializuar i institucionit shëndetësor A., ka qenë se kandidati në këtë rast paditësi është i papërshtatshëm në aspektin shëndetësor për të vazhduar më tutje me fazat e tjera të seleksionimit për zyrtar policor.

Gjykata pas administrimit dhe vlerësimit të provave si dhe vendimit të Drejtorisë së Përgjithshme të P.K. i datës 16.09.2019, konstatoj se e paditura i ka ndërmarr të gjitha veprimet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2018 për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës duke konstatuar se paditësi nuk ka përmbushur

standardin e përcaktuar sipas Procedurës Standarde të Operimit, Nr. PSO-DP-5.07, seksioni VI, pika E, ku parashihet se kandidati duhet të ketë aftësi shëndetësore për të kryer funksionet kryesore në vendin e punës në polici, dhe nga konstatimi i dhënë nga mjeku i specializuar i Klinikës A., ka rezultuar se kandidati është i pa përshtatshëm në aspektin shëndetësor, për të vazhduar me fazat tjera të seleksionimit për zyrtarë policor.

Gjykata vlerëson se, në cilëndo situatë, vlerësimi mjekësor i paditësit, edhe nga institucionet shëndetësore të tjera sipas iniciativës së tij, dhe prezantimi i rezultateve të tjera nga ato të konstatuara nga institucioni shëndetësor i autorizuar nga e paditura, nuk mund të kenë ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje, kjo për faktin se gjykata nuk mund të analizoj vlerat apo përmbajtjen e analizave laboratorike, e as të bëjë krahasimin e këtyre raporteve të analizave, sepse një vlerësim i tillë është në kompetencë të profesionistëve shëndetësor, e të cilat pretendime mund të vlerësohen nga ekspertët përkatës gjatë shqyrtimit gjyqësor, sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse, kjo për faktin se është detyrim i palëve të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ashtu siç përcaktohet me paragrafin 1 të nenit 7 të LPK-së. Ndërsa, gjykata rithekson se në kompetencën e saj, në rastin konkret, duke marr për bazë pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe provat e paraqitura, hynë vetëm vlerësimi nëse e paditura i ka ndjekur në mënyrën e duhur procedurat gjatë zhvillimit të procedurës sipas konkursit, dhe rrjedhimisht nëse janë zbatuar drejtë dispozitat ligjore gjatë fazave të rekrutimit të kandidatëve.

Rrjedhimisht, duke qenë se procedimi tutje i një kandidati varet në tërësi nga vlerësimi mjekësor, e paditura domosdo ka qenë e detyruar në marrjen e një vendimi të tillë në lidhje me paditësin, duke qenë se i njëjti është cilësuar si i papërshtatshëm për pozitën përkatëse të punës në aspektin shëndetësor. Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se shtrirja e juridiksionit të saj mbi veprimtarinë administrative të organeve publike, në këtë rast të paditurës, ka për qëllim të garantojë parimin e ligjshmërisë dhe kontrollin gjyqësor mbi veprimtarinë diskrecionare të saj, por në asnjë mënyrë për të zëvendësuar kompetencat të cilat ekskluzivisht i janë njohur sipas ligjit të paditurës.

Kurse, në lidhje me refuzimin e kërkesës së padisë së paditësit për të detyruar të paditurën që të njëjtin të sistemojë në vendin e punës si zyrtar policor, gjykata vlerëson se një kërkesë e tillë mund të shqyrtohet vetëm pas krijimit të bazës juridike, e që në rastin e paditësit do të ishte anulimi i vendimit përkatës të së paditurës, përkatësisht anulimi i Vendimit të Drejtorisë së Përgjithshme të P.K. i datës 16.09.2019. Prandaj, pasi që gjykata lidhur me këtë vendim, nuk e gjeti se i njëjti është i kundërligjshëm, vlerëson se nuk mund të urdhërojë të paditurën në sistemimin e paditësit në vendin përkatës të punës.

Për më shumë, kërkesa e paditësit për detyrimin e të paditurës për zgjedhjen e tij si zyrtar policor, nuk ka të bëjë me vërtetimin e ekzistimit të një drejte, por me krijimin e një të drejte të re, brenda një institucioni i cili aktualisht nuk është punëdhënës i paditësit. Kjo do të nënkuptonte njohje të drejtave të cilat rrjedhin nga marrëdhënia e punës, të cilat në rastin konkret për paditësin nuk mund të gjejnë zbatim, kjo për faktin se të drejtat e tilla, përfshijnë edhe detyrimet të cilat burojnë nga marrëdhënia e punës, për krijimin e të cilave, para gjykatës nuk u paraqitën prova.

Në lidhshmëri me të lartcekurat, e duke marr për bazë faktin se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor, e në përputhje me nenin 7 paragraf 1 të LPK-së, i cili përcakton rolin aktiv të të dyja palëve ndërgjyqëse gjatë procesit gjyqësor, sipas të cilit: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, gjykata vendosi sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, ku secila palë i bartë shpenzimet e procedurës, ashtu siç përcaktohet me nenin 450 të LPK-së.

Bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me dispozitat e neneve 142 dhe 143 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.2340/2022, datë 08.04.2024

Gjyqtari
Argzon Muçaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës me seli në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme.